ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KOSTT-23-1693-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve tip VW**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**„Baki Automobile" SH.P.K.**
NUI	**600011811**
Adresa	**Vëllezërit Fazliu**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**-**
Numri Telefonit	**044112854**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Baki Automobile**
Adresa elektronike	**info@bakiautomobile.com; anita.abdullahu@baki-vw.eu**
Data e parashtrimit të ankesës	**18.08.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve tip VW

Në platëformën elektronike të e-prokurimit janë publikuar njoftimet si në vijim:

1. Njoftimi për kontratë me datë: 06.03.2023

2. Afati i fundit për pranimin e tenderëve deri me datë: 12.04.2023 në 10:00, vendi KOSST përmes e-prokurimit.

3. Hapja e tenderëve me datë: me datë 12.04.2023 në ora 10:00, në KOSTT përmes e-prokurimit.

4. Procedurë e hapur

5. Vlera e parashikuar: 100,000.00

6. Lloji i kontratës: Shërbime.

7. Me datë 19.05.2023 kemi ushtruar kërkesë për rishqyrtim

8. Me datë 26.05.2023 AK ka nxerrë vendim lidhur me kërkesën për rishyrtim

9. Me datë 29.05.2023 AK ka publikuar njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës.

10. Me datë 01.06.2023 kundër vendimit të AK për aprovimin e pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim kemi ushtruar ankesë në OSHP.

11. Me datë 14.06.2023 eksperti shqyrtues ka nxjerrë rasportin shqyrtues lidhur me ankesën tonë duke propozuar që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM.

12. OSHP me vendimin 2023/0338 të dt. 19.06.2023, e ka përfunduar procedurën e shqyrtimi të ankesës tonë, për shkak të pajtimit të arritur mes palëve, Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik "Baki Automobile" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve tip VW", me numër të prokurimit KOSTT-23-1693-2-2-1.

13. AK pas rivlerësimit të II-të të tenderëve, operatorin ekonomik "Reforma" përsëri e ka ka shpallur fitues.

14. Ne kemi paraqitur kërkesën II-të për rishqyrtim në AK.

15. Autoriteti Kontraktues përsëri e ka aprovuar kërkesën tonë për rishqyrtim dhe tenderin e ka kthyer në rivlerësim.

16. Pas rivlerësimit të III-të të tenderëve, AK përsëri e ka shpallur fiturs O.E "Reforma".

17. Ne kemi paraqitur kërkesën e III-të për rishqyrtim.

18. AK përmes vendimit të datës 11.08.2023 e ka refuzuar në tërësi kërkesën tonë për rishqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datë 15.05.2023 është publikuar njoftiim B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontaktues. Përmes këtij njoftimi operatori ekonomik "Reforma" sh.p.k është shpallur tendrues i suksesshëm ndërsa kompania jonë "Baki Automobile" sh.p.k është shpallur tenderues i pasukseshëm.

Me datë 19.05.2023 ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim duke kërkuar që të aprovohet kërkesa jonë për rishqyrtim dhe të bëhet ekzaminimi, vlerësim dhe krahasimi i tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe pikën 10.1 Udhëzuesit Nr.001/2023 dhe nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, ashtu që gjatë rivlerësimi të tenderëve AK të refuzojë tenderin e operatorit ekonomik "Reforma" sh.p.k pa kërkuar informacion të mëtejshëm ndërsa kompaninë tonë ta shpallë si tenderues të suksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Me datë 26.05.2023 Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendimin lidhur me kërkesën tonë për rishqyrtim, duke konstatuar si në vijim:

KOSTT pajtohet pjesërisht me pretendimet e juaja:

- **Pajtohemi me konstatimin e juaj se i mungojnë dëshmitë sipas kërkesës së parashtruar në specifikimin teknik.**
- **Nuk pajtohemi me pretendimin e juaj se i mungon specifikimi teknik dhe se**

nuk mund të kërkohen dokumentet e lartcekura.

Pas rivlerësimit të tenderëve AK përsëri e ka shpallur fitues operatorin ekonomik "Reforma". Ne kemi kërkuar çasje në dosjen e operatorit ekonomik fitues dhe kemi vërejtur shkelje të mëdha ligjore dhe kemi vërejtur se ky operator nuk ka dorëzuar deklaratë lidhur me specifikacionin teknik. Autoriteti Kontraktues përmes vendimit të dt. 26.05.2023 e ka aprovuar kërkesën tonë për rishqyrtim, e ka anuluar Njoftimin B58 dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Në procedurën e rivlerësimit të III-të, AK përsëri e ka shpallur fitues operatorin ekonomik "Reforma". Ne përsëri kemi kërkuar çasjse në dosjen e operatorit ekonomik fitues. Pas analizimit të dokumenteve të dorëzuara nga operatori ekonomik fitues "Reforma", kemi vërejtur se ky operator nuk është i përgjegjshëm dhe mbi këtë bazë kemi paraqitur për herë të III-të kërkesë për rishqyrtim. Autoriteti Kontraktues përmes vendimit të datës 11.08.2023 e ka refuzuar në tërësi kërkesën tonë për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

<u>Ligji i Prokurimit Publik:</u>

Neni 1 i LPP-së,

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

<u>Legjislacioni sekondar:</u>

Pika 10.1 e UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 38 i Rregullores Nr.001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues me vendimin e datës 11.08.2023 e ka refuazuar në tërësi kërkesën tonë për rishqyrtim duke dhënë një arsyetim të njëjtë *"copy-paste"* për të gjitha pretendimet tona, si në vijim:

Reforma ka dorëzuar Deklartë të Specifikimit teknik sikur Ju në ofertën tuaj.

Komisioni Rivlerësues bazuar në LPP e ka kthyer procesin e vlerësimit në pikë 0 (fillestare).

Komisioni Rivlerësues bazuar në nenin 38 të Rregullores në fuqi dhe nenin 72, i ka qartësuar deklaratat e dorëzuara në ofertën bazë të OE. Nuk ka shtim të dokumentacionit në asnjë aspekt. Parimet themelore të LPP janë respektuar në plotëni.

Pra, të gjitha pretendimet të tona të paraqitura përmes kërkesës për rishqyrtim janë refuzuar nga AK duke thënë një arsyetim krejtësisht të njëjtë *"copy-paste"*.

Sqarojmë se me datë 03.07.2023 ne kemi paraqitur kërkesën e II-të për rishqyrtimin e vendimit të përmes të cilit operatori ekonomik "Reforma" është shpallur si tenderues i suksesshëm.

Autoriteti Kontraktues përsëri për herë të dytë e ka aprovuar kërkesën tonë për rishqyrtim dhe e anulon Njoftimin B58 dhe e përsëri e kthen lëndën në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues me datë 04.08.2023 ka publikuar Njoftimin B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit përmesëri operatori ekonomik "REFORMA" është shpallur tenderues i suksesshëm.

Njoftimi B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues është nxjerrë duke u bazuar në 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik!!! Mirëpo, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk është më në fuqi për shkak se nga data 01.11.2022 ka hy në fuqi Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurim Publik ndërsa nga data 01.02.2023 ka hy në fuqi Udhëzusi Nr-001/2023 për Prokurimin Publik. Prandaj, rezulton se Njoftimi B58 bazohet në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, i cili veçse është i SHFUQIZUAR para inicimit të këtij aktivitetit të prokurimit.

Duke u bazuar në faktin se operatori ekonomik "Reforma" asnjëherë nuk kishte dorëzuar specifikim teknik për mallrat e ofruar, Autoriteti Kontraktues tani në herën e tretë të rivlerësimit të tenderëve përmes kërkesës për sqarim të tenderit ka kërkuar nga operatori ekonomik "Reforma" që paraqet DEKLARTË MBI SPECIFIKIMIN TEKNIK!!!

Po ashtu, AK në faqen 8 të vendimit kontestues e konfirmon faktin se në procedurën e tretë të rivlerësimit të tenderit ka kërkuar nga OE "Reforma" që të dorëzoj deklartë lidhur me kërkesën e specifikimit teknik. Me këtë vërtetohet fakti se OE "Reforma" në momentin e dorëzimit të tenderit nuk kishte dorëzuar deklartë për specifikimin teknik, mirëpo këtë deklaratë e ka paraqitur në procedurën e tretë të rivlerësimit të tenderëve.

Prandaj, konsiderojmë se Autoritetit Kontraktues ka vepruar në shkelje të pikës 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 duke kërkuar nga OE "Reforma" dorëzimin e deklaratave të reja *(të cilat është obligim të dorëzohen ne momentin e dorëzimit të tenderit).*

Po ashtu, vlerësojmë se Autoritetit Kontraktues përmes kërkesës për sqarimin e tenderëve ka vepuar edhe në shkelje të nenit 72 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Neni 72.3 i LPP-së ka përcaktur qartë që kërkesa për sqarime apo sigurimi i informacioneve mund të bëhet vetëm për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, ndërsa në rastin konkret deklarata për specifikimin teknik nuk është dorëzuar fare në momentin e dorëzimit të tenderit të OE "Reforma", ndërsa AK përmes kërkesës për sqarim të tenderit ka kërkuar nga OE "Reforma" dorëzimin e deklaratës për specifikim teknik. Kjo paraqet ndryshim material dhe nuk mund të verifikohet ashtu siç e parasheh

dispozita e nenit 72.3 të LPP-së.

Pra, vetëm në procedurën e tretë të rivlerësimit të tenderëve, operatori ekonomik 24.07.2023 ka paraqitur DEKLARATE MBI SPECIFIKAT TEKNIKE!!! Për ta vërtetuar këtë ju lutem shihni deklaratën e dt.24.07.2023 mbi specifikat teknike të paraqitur nga OE "Reforma".

Paraqitja e deklaratës së datës 24.07.2023 mbi specifikat teknike nga "Reforma", vërteton faktin se këtij operatori ekonomik i ka mungur specifikimi teknik deri me dt. 24.07.2023 përkatësisht kjo vërteton faktin se OE "Reforma" nuk ka paraqitur specifikacion teknik në momentin e dorëzimit të tenderit. Prandaj rezulton se OE "Reforma" për herë të parë ka paraqitur deklartë për specifikimin teknik me datë 24.07.2023 dhe atë në procedurën e tretë të rivlerësimit të tenderëve.

Ne në vazhdimësi që nga fillimi i procedurës, përmes kërkesës së parë dhe të dytë për rishqyrtim kemi argumentuar dhe vërtetuar se operatorit ekonomik "Reforma" i ka munguar specifikimi teknik për mallrat e ofruara, prandaj Autoriteti Kontraktues është dashur që të refuzoj tenderin e operatorit ekonomik "Reforma" pa kërkuar informacion të mëtejshëm, ashtu siç e përcakton në mënyrë shprehimore pika 10.1 e Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokruimin Publik në ndërlidhje me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Pra, paraqitja e deklaratës së dt. 24.07.2023 mbi specikat teknike nga OE "Reforma" vërteton faktin se këtij operatori ekonomik i ka mungur specifikacioni teknik në momentin e dorëzimit të tenderit dhe në këtë rrethana Autoriteti Kontraktues duhet të refuzojë tenderit e këtij operatorit ekonomik pa kërkuar informacion të mëtejshëm, ashtu siç e përcakton pika 10.1 e Udhëzusit Nr.001/2023, si në vijim:

"Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, nëse: Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara...".

Ne ritheksojmë se operatori ekonomik "Reforma" përmes paraqitjes së deklaratës mbi specifikat tenknike me datë 24.07.2023, e vërteton faktin se këtij operatori ekonomik i ka munguar specifikacioni teknik për mallrat e ofruar. Prandaj, në këto rrethana Autoriteti Kontraktues duhet veprojë konform pikës 10.0 të Udhëzuesit Nr.001/2023 dhe të refuzojë

tenderin e operatorit ekonomik “Reforma” pa kërkuar informacion të mëtjeshëm.

Sqarojmë se sikur operatori ekonomik “Reforma” në momentin e dorëzimit të kishte dorëzuar specifikacionin teknik për mallrat e ofruara, atëherë është joligjike dhe e panevojshme dorëzimi i specikacionit teknik me datë 24.07.2023 në procedurën e tretë të vlerësimit/rivlerësimit të tenderëve.

Duke u bazuar në rrethanat e rastit, ne vlerësojmë se tanimë nuk është kontestues fakti vendimtar që operatorit ekonomik “Reforma” i ka munguar specifikacioni ekonomik për mallrat e ofruar. Këtë fakt parimisht e konfirmon edhe vet operatori ekonomik “Reforma” me datë 24.07.2023 duke paraqitur deklaratë mbi specifikat teknike. Pra, ky operator ekonomik me datë 24.07.2023 ka paraqitur për herë të parë specifikacionin teknik në procedurën e tretë të vlerësimit të tenderit.

Duke sqaruar dhe interpretuar rëndësinë e specifikacionit teknik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), me datë 22.06.2023, ka dhënë opnion, si në vijim:

13. 22.06.2023 Si duhet të veprojë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së?

Specifikimet teknike pjesë thelbësore e tenderit, prandaj, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet.

Link: https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=545

Prandaj, duke u bazuar edhe në opinioni e lartcekur të KRPP-së rezulton se specifikimet teknike janë pjesë thelbësore e tenderit, prandaj tenderi edhe nëse specifikmet teknike dorëzohen në një gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, tenderit duhet të përjashtohet. Pra, edhe nga ky opinon i KRPP-së vërtetohet se Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë që të sqarojë specifikimin teknik e aq më tepër paraqitjen e specikacionit teknik pas përfundimit të afatit për pranimin e tenderëtve.

Lidhur me sqarimin e tenderëve theksojmë se AK mund të ftojë OE për të qartësuar dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE. Mirëpo, për këto dokumente, megjithatë, operatorët ekonomikn në mënyrë objektive duhet të prezantojnë se kane ekzistuar para afatit të fundit te dorëzimit të aplikacionit apo të dorëzimit të tenderit. Në rastin konkret, është vërtetuar se deklarata për specifikimet teknike për mallrat e ofruar nuk ka ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve, por deklarata për specifikacionin teknik është dorëzuar për herë të parë nga operatori ekonomik "Reforma" me datë 24.07.2023!!!

Prandaj vlerësojmë se sipas nenit 72 të Ligjit të Prokurimit Publik mund të kërkojë vetëm sqarimin e deklaratave dhe dokumenteve të dorëzuara të cilat kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, mirëpo përmes kërkesës për sqarimin e tenderëve nuk mund të kërkohet paraqitja e dokumenteve ose e dokumenteve të cilat nuk kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve, sepse kjo përbën shkelje të rëndë të nenit 72 të LPP-së.

Në rastin konkret, OE "Reforma" në procedurën e rivlerësimit të tenderit përmes sqarimit të tenderit ka paraqitur dokumente / deklarata të reja të cilat nuk kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve. "Reforma" në procedurën e rivlerësimit të tenderëve, me datë 24.07.2023 për herë të parë ka paraqitur deklaratë për specikimin teknik. Kjo deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE "Reforma" mbanë datën 24.07.2023, që dëshmon faktin se kjo deklaratë nuk ka ekzistuar dhe nuk është paraqitur para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.

PROCEDURA PARAPRAKE E VLERËSIMEVE TË MËHERSHME TË TENDERIT

Me datë 15.05.2023 Autoriteti Kontraktues [tutje referuar: AK] ka publikuar njoftimin B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontaktues përmes të cilit AK e ka shpréblyer me kontratë Operatorin Ekonomik "Reforma" sh.p.k me seli në Obiliq. Po ashtu, përmes njoftimit të lartcekur jemi njoftuar se kompania jonë është shpallur tendrues i pasuksesshëm.

Pas pranimit të vendimit të lartcekur, ne kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik fitues.

Pas analizimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kompania “Reforma”, kemi vërejtuar se tenderi i këtij operatori ekonomik është dashur që të refuzohet duke u bazuar në pikën 10.1 të UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, për faktin se ky operatori ekonomik nuk ka përmbushur kërkesat nga pika 3.0 dhe 3.2 të përcaktuara tek specifikimi teknik “DT-OT-019 Lot 1”.

Me datë 19.05.2023 ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim duke propozuar që të aprovohet kërkesa jonë për rishqyrtim dhe të bëhet ekzaminimi, vlerësim dhe krahasimi i tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe pikën 10.1 Udhëzuesit Nr.001/2023 dhe nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, ashtu që gjatë rivlerësimi të tenderëve AK të refuzojë tenderin e operatorit ekonomik “Reforma” sh.p.k pa kërkuar informacion të mëtejshëm ndërsa kompaninë tonë ta shpallë si tenderues të suksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Me datë 26.05.2023 Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim duke aprovuar vetëm pjesërisht kërkesën tonë për rishqyrtim si në vijim:

KOSTT pajtohet pjesërisht me pretendimet e juaja:

Pajtohemi me konstatimin e juaj se i mungojnë dëshmitë sipas kërkesës së parashtruar në specifikimin teknik

Nuk pajtohemi me pretendimin e juaj se mungon specifikimi teknik dhe se nuk mund të kërkohen dokumentet e lartcekura.

Pasi që nuk jemi pajtuar me vendimin e lartcekur të Autoritetit Kontraktues, ne me datë 01.06.2023 kemi paraqitur ankesë në OSHP në lëndën 338-23.

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 14.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

ANKESA TË APROVOHET SI E BAZUAR;

TË ANULOHET VENDIMI I ATAKUAR I AK DHE LËNDA TË KTHEHET NË RIVLERËSIM;

Duke u bazuar në konstatimin e eskpertit shqyrtues, OSHP-ja ka nxjerrë vendimin OSHP: 2023/0338 të datës 19.06.2023.

Në rastin konkret, edhe ekspertit shqyrtues i OSHP-së si dhe vet OSHP-në përmes vendimit të lartcekur ka konstuar se ankesa jonë duhet të aprovohet në tërësi. Mirëpo, përkundër kësaj Autoriteti Kontraktues duke vepruar në kundërshtim me ekspertizën e ekspertit shqyrtues të prokurimit, përsëri ka vendosur që ta shpallë si tenderues të sukseshëm operatorin ekonimik Reforma sh.p.k.

Pasi që lëndë është kthyer në rivlerësim, Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit shqyrtues e as vendimin e OSHP-së për faktin se përmes kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar nga operatori ekonomik Reforma sh.p.k, sqarimin e tenderit, si në vijim:

Na ofroni udhëzimet/dëshmitë nga garantuesi (Porsche Kosova) se dy automjetet SKODA OCTAVIA 2.0 TDI janë në afat Garancioni deri me 14.10.2024. Dëshmia në fjalë kërkohet që të vërtetohet se do të na vlejë Garancioni për këto automjete.

Dëshmoni me deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur se çdo pjesë (pozicion) i ndërruar do të jetë origjinal dhe për të gjitha pozicionet e lartshënuara Garancioni do të jetë së paku një vjeçar (ose kilometra sipas udhëzimeve të prodhuesve), kurse për bateri duhet të ofrohet garancioni së paku dy vjeçar.

Konsiderojmë se në rastin konkret gjatë rivlerësimit është vepruar në kundërshtim me pikë 10.1 të Udhëzuesiz Nr. 001/2023 për prokurim publik, i cili në mënyrë të qartë përcakton se **duhet të refuzohet tenderit pa kërkuar informacion të mëtejshëm**, në rastin kur:

Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne

përputhje me specifikimin e kërkuar).

Po ashtu, sqarojmë se lidhur me kërkesën e lartcekur kompania jonë ka paraqitur deklaratë për ta përmbushur këtë kërkesë të specifimit teknik ndërsa operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratë lidhur me kërkesën e lartcekur të specifikimit teknik.

Autoriteti Kontraktues gjatë rivlerësimi ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik për faktin se përmes kërkesës për sqarimin e tenderit AK ka kërkuar nga operatori ekonomik paraqitjen e dokumenteve të reja të cilat dokumente nuk kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të tenderit.

Neni 72 par. 3 i Ligjit për Prokurim Publik, përcakton si në vijim:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Sqarojmë se deklarata për specifikimin teknik është dëshmi për të treguar se operatori ekonomik i plotëson kualifikimet minimale (që në fazën e tenderimit) të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës dhe si e tillë kjo deklaratë nuk mund të kërkohet në bazë të nenit 72 të LPP-së.

Pra, deklarata për specifikimin teknik nuk është një dokument i cili e plotëson kërkesën nga neni 72 par. 3 i LPP-së, për këtë arsye deklarata për specifikimin teknik, duhet të nënshkruhet, vuloset dhe dorëzohet së bashku me tender para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve të specifikuar në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Operatorit Ekonomik "Reforma" sh.p.k i ka munguar specifikacioni teknik për mallrat e ofruar. Në këto raste konform pikën 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për prokurim publik, **duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm.**

Gjatë rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me pikë 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 dhe nenit 72 të LPP-së, për faktin se në vend që ta refuzojë tenderin e operatorit ekonomik Rerforma sh.p.k, ka kërkuar nga ky operator ekonomik që të dëshmojë me deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur se çdo pjesë (pozicion) i ndërruar do të jetë origjinal dhe për të gjitha pozicionet e lartshënuara garancioni do të jetë së paku një vjeçar (ose kilometra sipas udhëzimeve të prodhuesve), kurse për bateri duhet të ofrohet garancion së paku dy vjeçar.

Pra, Autoriteti Kontraktues gjatë rivlerësimit të tenderit ka kërkuar paraqitijen e deklaratës së re e cila nuk ka qenë e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së si dhe me pikën 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për prokurim publik.

Po ashtu, sqarojmë faktin se AK gjatë fazës së mëhershme të rivlerësimit kishte kërkuar që Reforma sh.p.k të paraqesë deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur lidhur me specifikimin teknik-garancionin, mirëpo Reforma sh.p.k ka paraqitur vetëm SQARIM LIDHUR ME TENDERIT por nuk ka paraqitur DEKLARATË TË VEÇANTË të nënshkruar dhe të vulosur lidhur me specifikimin teknik-garancionin. Pra, edhe në herën e dytë (II) të rivlerësimit të tenderit, operatori ekonomik Reforma sh.p.k ka paraqitur vetëm sqarim të tenderit mirëpo nuk ka paraqitur deklaratë lidhur me specifikimin teknik.

Me datë 24.07.2023 OE "Reforma" për herë të parë paraqetë deklaratë për specifikacion teknik dhe në këtë mënyrë vërtetohet pretendimi jonë që nga fillimi i procedurës, që operatorit ekonomik "Reforma" ia ka mundur specifikacioni teknik dhe në këtë mënyrë konform pikës 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për prokurim publik, tenderi i OE "Reforma" duhet të refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Operatori ekonomik Reforma sh.p.k nuk ka paraqitur prova që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për Kontratë, dhe në këtë mënyrë është vepruar në kundërshtim me nenin 38 par. 3 të Rregullores Nr.001/2023 për prokurim publik.

Pra, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e dorëzimit të tenderit nga operatori ekonomik, rezulton fakti se kjo kompani nuk ka paraqitur deklaratë – specifikacion teknik për mallrat e ofruar ashtu siç kërkohej në pikën 3.0 dhe 3.2 të kushteve të përgjithshme të specifikimit teknik "DT-OT-091 Lot 1".

Prandaj, qartë rezulton fakti se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, rivlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar në shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe pikës 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për prokurim publik për faktin se tenderi i kompanisë "Reforma" sh.p.k është dashur që të refuzohet pa kërkuar informacione të mëtutjeshme, pasi që kjo kompani në momentin e dorëzimit të tenderit nuk ka paraqitur specifikimin ashtu siç kërkohej në pikën 3.0 dhe 3.2 të kushteve të përgjitshme të të specifikimit teknik "DT-OT-091 Lot 1".

Pra, nga analizimi i dokumenacinit të operatorit ekonomik fitues "Reforma" sh.p.k, të cilin AK ka vendosur që ta shpërblejë me kontratë, kemi vërejtur se AK ka bërë shkelje të LPP-së gjatë rivlerësimi të tenderëve, pasi që gjatë rivlerësimi të tenderëve nuk i ka zbatuar kërkesat të cilat vet AK i ka përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Në rastin konkret duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit konsiderojmë se AK duhet të refuzojë tenderin e operatorit ekonomik "Reforma" pa kërkuar informacone të mëtutjeshme konform pikë 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 dhe nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik.

SKADIMI I VALIDITETIT TË TENDERIT

Afati për dorëzimin e tenderëve: 12.04.2023

Periudha e vlefshmërisë së tenderit: 60 ditë

Data e skadimit të vlefshmërisë së tenderit: 13.06.2023

Kërkesa e AK për vazhdim të vlefshmërisë së tenderëve: 06.07.2023

Ndërkohë, kemi vërejtuar se AK ka kërkuar vazhdimin e validitetit të tenderit gati një muaj pas skadimit të vlerfshmërisë së tenderit.

Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurim Publik në nenin 30.4, përcakton që:

AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)

Lidhur me vazhdimin e vlefshmërisë së tenderëve, KRPP me datë 22.11.2023 ka dhënë interpretim si në vijim:

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

(Ky interpretimi i KRPP-së është publikuar në webfaqen: https://e-prokurimi.rks-gov.net/)

Në rastin konkret, AK përmes kërkesës për vazhdimin e vlefshmërisë së tenderëve që kërkuar që: Vlefshmëria e tenderit të vazhdohet nga data e skadimit deri me datë 30.08.2023.

Shih: Kërkesën e AK të dt. 06.07.2023 për vazhdimin e vlefshmërisë së tenderëve.

Pra, rezulton fakti se AK pas skadimit të vlerfshmërisë së tenderëve ka kërkuar që në mënyrë retroaktive të bëhet vazhdimi i vlefshmërisë së tenderëve nga data e skadimit. Këto lëshime dhe veprime të Autoritetit Kontraktues përbëjnë shkleje të rëndë të nenit 30.4 të Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Përfundimisht, ne vlerësojmë se paraqitja e dokumenteve ose deklaratave të reja përnes sqarimit të tendrit, të cilat dokumente ose deklarata nuk kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, përbën shkelje të rëndë të nenit 72 të LPP-së dhe nenit 33.3 të Rregullore Nr.001/2022 për prokurimin publik.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar si të përgjegjshëm operatorin ekonomik "Reforma", edhe pse qartë rezulton faktin se këtij operatori ekonomik i ka munguar specifikacioni teknik për mallrat e ofruar. Në këtë rast është vepruar në shkelje të pikës 10.1 të UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, për faktin se tenderit i OE "Reforma" duhet të refuzohet pa kërkuarinformacion të mëtejshëm, konfrom pikës 10.1 të UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe nenit 28 të LPP-së.

Prandaj, bazuar në argumentet e lartcekura ne vlerësojmë se gjatë procedurës së rivlerësimi të tenderëve Autoriteti Kontraktues ka vepruar në shkelje të rëndë të nenit 28, 59 dhe 72 të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe në kundërshtim të plotë me nenin 38.3 të Rregullores Nr.001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK si dhe në kundërshtim të plotë me pikën 10.1 të UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.

PROPOZIMI

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që menjëherë të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të pazullojë aktivitetin e prokurimit në këtë procedurë ndërsa pas shqyrtimi të ankesës i propozojmë OSHP-së, që **ta aprovojë në tërësi ankesën** tonë, lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe duke obliguar AK që gjatë fazës së rivlerësimi të respektojë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, në Dosjen e Tenderit si dhe kërkesat e përcaktuar në specifikimin teknik "DT-OT-091 Lot 1".

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke u bazuar në shkeljet e rënda dhe të përsëritura të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues, kompanisë tonë do t'i shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale. Ne për përgatitjen e tenderit kemi bërë shpenzime të konsiderueshme. Po ashtu, kompanisë tonë i shkaktohet fitim i humbur për shkak se ne nuk jemi shpallur tenderues i suksesshëm edhe pse ne jemi operatori i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*